

Elektrodistribucija DOOEL është një kompani, aktiviteti kryesor i së cilës është shpërndarja e energjisë elektrike në territorin e të gjithë vendit. Qëllimi kryesor është furnizim i besueshëm dhe cilësor me energji elektrike.

Ju ftojmë të merrni pjesë në Programin tonë të mësimit dhe zhvillimit:

EVN - GJENERATA E RE

Cilët janë kandidatët që ne kërkojmë?

Inxhinierë të vitit të fundit ose të diplomuar në programet e Sistemit Energjetik. Nga kolegët tanë të ardhshëm ne presim që të jenë të hapur, të përkushtuar, të disiplinuar, kanë qasje konstruktive dhe aftësi për t'iu përshtatur situatave dhe mjediseve të ndryshme, si dhe gatishmëri për të punuar në qytete të ndryshme të vendit.

Çfarë ofrojmë?

Kontrat pune njëvjeçare, me mundësi për të zgjatur kontratën. Sistemi i mentorimit, përfshirja e drejtpërdrejtë në procesin e punës dhe trajnimi i specializuar nga ekspertë afatgjatë në këtë fushë.

Ku zhvillohet programi?

Ju do të kryeni detyrat në Qendrat Energjetike të Konsumatorëve në Shkup, Manastir, Prilep, Ohër, Strugë, Kërçovë, Gostivar, Tetovë, Veles, Kumanovë, Kratovë, Strumicë, Gjevgjeli, Kavadarci, Delçevë, Kocani dhe Shtip, ku do të trajnoheni dhe përgaditeni për sfidat e ardhshme.

Sa kohë zgjat programi?

Programi zgjat 12 muaj dhe përfshin rotacione me kohëzgjatje prej 6 muaj në dy Qendrat Energjetike të Konsumatorëve. Përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në projekte do të keni mundësi për të zhvilluar potencialet tuaja.

Dëshironi të aplikoni?

Dërgoni CV-në tuaj, një letër motivimi dhe konfirmim të provimeve të kaluara në jobs.elektrodistribucija@evn.mk me mbishkrim "IGEVN" më së voni deri më **31.05.2022**.

Të gjithë ata që plotësojnë kriteret janë të ftuar të aplikojnë

Elektrodistribucija DOOEL është një kompani që ofron mundësi të barabarta dhe trajtim të drejtë në punësim për të gjithë njerëzit pavarësisht nga raca ose përkatësia etnike, ngjyra e lëkurës, gjinia, mosha, gjendja shëndetësore, përkatësisht aftësia e kufizuar, besimi fetar, politik ose tjetër, pjesëmarrje në sindikat, origjina kombëtare ose sociale, statusi familjar, situata pronësore, orientimi seksual ose rrethana të tjera personale.